




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 39 pika 1.4, nenin 49 paragrafi 2.8 dhe paragrafi 4 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-53125 të datës 11.11.2011, Kuvendi Komunal i Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më 27.05.2014, aprovoi këtë:

VENDIM

Për bartjen e shpenzimeve postare të pilot projektit "Home Komuna-Apliko Online"

1. Me këtë Vendim Kuvendi i Komunës bartë shpenzimet postare të pilot projektit "HOME KOMUNA-APLIKO ONLINE", me rastin e aplikimit për dokumentacion të gjendjes civile, për një periudhë gjashtë (6) muajore, aq sa zgjat edhe pilot projekti.
2. Mjetet financiare për mbulimin e shpenzimeve të pilot projektit si në pikën 1 të këtij vendimi ndahen nga buxheti i Komunës-Kodi buxhetor i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, ndërsa për monitorimin e zbatimit të kujdeset Kryesuesja e KK-Gjilan.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr. 016-58785
Gjilan, më 27.05.2014

Kryesuesja e Kuvendit,
Valentina Bunjaku-Rexhepi